

**20090520880**

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR TRASHËGIMI JURIDIKE TË**  
**REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR ANËTARËSIM NË FONDIN**  
**MONETAR NDËRKOMBËTAR**

Neni 1

Në Ligjin për trashëgimi juridike të Republikës së Maqedonisë për anëtarësim në Fondin Monetar Ndërkombëtar ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 23/93) neni 2 ndryshon si vijon:

"Në territorin e Republikës së Maqedonisë janë në fuqi dispozitat e Statutit të Fondit me ndryshimet dhe plotësimet e 28 shtatorit 1969, 1 prillit 1978 dhe 11 nëntorit 1992, si dhe të 28 prillit 2008 dhe të 5 majit 2008."

Neni 2

Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të Fondit të 28 prillit 2008 dhe të 5 majit 2008 nga neni 1 i këtij ligji, do të hyjnë në fuqi me ditën e njoftimit formal të Fondit se ndryshimet dhe plotësimet e propozuara janë pranuar nga tri të pestat e anëtarëve që kanë 85% nga trupi i përgjithshëm votues.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".